



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-022

**PËR PËRKRAHJE MATERIALE FAMILJEVE TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË
KUFIZUAR TË PËRHERSHME**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të kreut 5.1 (j) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë;

Duke u nisur nga fakti se Kosova garanton të drejtat e përcaktuara me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;

Duke u nisur nga fakti se në Kosovë ndalohet diskriminimi i fëmijëve në çfarëdo baze;

Duke pasur parasysh rëndësinë, rolin dhe vështirësitë e familjes në mbrojtjen dhe kujdesin për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme,

Miraton këtë

**LIGJ PËR PËRKRAHJE MATERIALE FAMILJEVE TË FËMIJËVE ME AFTËSI
TË KUFIZUAR TË PËRHERSHME**

KREU I

Dispozitat themelore

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet e drejta për përkrahje materiale familjeve të cilët ruajnë dhe përkujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme dhe mënyra e realizimit të kësaj përkrahje materiale.

Neni 2 Përkufizimet

Shprehjet e përmendura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

“Fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme fizike, mendore dhe shqisore” konsiderohen fëmijët nga lindja deri në moshën 18 vjeçare me vendbanim të përhershëm në Kosovë, të cilët janë plotësisht të paaftë të kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore pa kujdesin e personit tjetër.

“Parashtruesi i kërkesës për ndihmë materiale dhe kujdes” nënkupton personin që paraqet kërkesën për përkrahje materiale.

“Autoriteti përkatës” nënkupton Departamentin e Mirëqenies Sociale ose ndonjë organ tjetër të cilin MPMS-ja e autorizon për administrimin e përkujdesjes .

“Përkujdesje” nënkupton një beneficion që administrohet nga MPMS-ja, dhe shërben për të ofruar mbështetje materiale personave që e ofrojnë këtë ndihmë dhe kujdes.

“Përkrahje materiale” është beneficion në formë të shumës financiare mujore ose formë tjetër e shpërblyer në të holla që administrohet nga MPMS-ja , për familje me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme.

“Komisioni mjekësor” nënkupton një grup të përbërë prej ekspertëve mjekësor, të emëruar nga MPMS-ja për ta përcaktuar shkallën e gjendjes shëndetësore të fëmijut.

“Ekspert” nënkupton personin që ka kryer specializimin nga fusha e mjekësisë dhe është i licencuar si ekspert.

“Shuma mujore” nënkupton shumën e saktë të mjeteve materiale që duhet t’i paguhet familjes me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme.

“Bashkësia familjare” përkufizohet si një grup individësh që jetojnë bashkë nën një kulm dhe që bashkërisht ndajnë shpenzimet e jetesës. Sipas këtij Ligji, bashkësia familjare mund të përfshijë personat që nuk janë anëtarë të familjes në kuptimin e ngushtë.

“Familja” është bashkësi e cila përbëhet nga paraqitësi i kërkesës dhe të gjithë anëtarët e tjerë të familjes që ndodhen në bashkësinë familjare: bashkëshorti ose partneri i cili jeton bashkë me të, prindërit dhe fëmijët duke përfshirë edhe fëmijët e adoptuar, fëmijët e vendosur në familje, ose fëmijët e njërit nga partnerët.

“Vendim” është akti juridik të cilin e nxjerr autoriteti përkatës, Departamenti i Mirëqenies Sociale, për njohjen e të drejtës në ndihmë materiale familjes ose personit tjetër i cili kujdeset për fëmijën me aftësi të kufizuar.

“Ekspertiza” nënkupton procedurën e vërtetimit të llojit, shkallës së dëmtimit fizik, mendor, shqisore apo të kombinuar.

“Aftësia e kufizuar e përhershme” nënkupton gjendjen shëndetësore të fëmijës i cili plotësisht dhe përherë nuk mund të lëvizë ose të kryejë aktivitetet e përditshme jetësore pa ndihmën e personit tjetër.

“Fëmijë” nënkuptohet çdo person nën moshën 18 vjeçare me përjashtim kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.

“MPMS” nënkupton Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Neni 3

3.1 Me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përpilon strategjinë e vet për këtë kategori të fëmijëve.

3.2 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, siguron përkrahje materiale familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme, në pajtim me mundësitë buxhetore të Kosovës.

3.3 Ndihma materiale familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme, do të ofrohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përmes Departamentit të saj të Mirëqenies Sociale.

3.4 Ndihma materiale mundëson fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme të bëjnë një jetë më normale në kushtet që garantojnë dinjitetin e tyre dhe lehtësojnë jetën e tyre.

3.5 Ndihma materiale për fëmijën e me aftësi të kufizuar të përhershme paguhet në emër të prindit apo kujdestarit të fëmijës, përmes xhironlogarisë bankare.

KREU II

Realizimi i të drejtës në ndihmë materiale

Neni 4

4.1 E drejta në ndihmë materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme realizohet në formë të përkrahjes financiare në para.

4.2 Këto mjete materiale i jepen familjes ose kujdestarit i cili e ofron ndihmën dhe kujdesin për fëmijën me aftësi të kufizuar të përhershëm për të cilin i është njohur kjo e drejtë.

4.3 Lartësia dhe afatet për dhënien e ndihmës materiale përcaktohen me akte nënligjore të nxjerra nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Ndihma dhe kujdesi për plotësimin e aktiviteteve të përditshme jetësore u takon fëmijëve më aftësi të kufizuar të përhershme të moshës 1-18 vjeçare, që janë qytetarë të Kosovës dhe janë me aftësi të kufizuar të përhershme që në mënyrë të pavarur të lëvizin dhe t'i kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore, ku për këta persona është i nevojshëm kujdesi i huaj 24 orësh.

Neni 6

Fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme konsiderohen:

- a) fëmijët e palëvizshëm,
- b) fëmijët plotësisht të verbër si dhe,
- c) fëmijët të cilët për shkak të natyrës së sëmundjes apo sëmundjeve të përhershme, nuk janë të aftë që në mënyrë të pavarur të lëvizin vetë, në banesë, apo në vendet ku kanë nevojë, as në përdorimin e ndihmesave përkatëse, nuk janë në gjendje të ushqehen vetë, të zhvishen dhe të vishen, të kryejnë nevojat fiziologjike si dhe të mbajnë higjienën e domosdoshme personale.

KREU III

Komisioni vlerësues për përcaktimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme

Neni 7

Komisioni vlerëson llojin, shkallën, dhe peshën e shëndetit fizik, mendor apo shqisor të dëmtuar të fëmijës me aftësi të kufizuar të përhershme.

Neni 8

8.1 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nxjerr vendim për themelimin e komisionit mjekësor për vlerësimin e shëndetit të fëmijëve me aftësi të kufizuar të cilët gëzojnë mbrojtjen e veçantë me këtë Ligj.

8.2 Me këtë vendim përcaktohet kompetenca territoriale e komisionit mjekësor.

8.3 MPMS-ja me aktvendim të veçantë themelon komisionin e shkallës së parë dhe komisionin mjekësor të shkallës së dytë.

Neni 9

Përbërja e komisionit mjekësor dhe procedurat e njohjes së të drejtës në ndihmë e kujdes

9.1 Komisioni mjekësor përbëhet prej pesë (5) ekspertë.

9.2 Komisioni mjekësor përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari i komisionit, dhe tre (3) anëtarë, dhe numër të njëjtë të zëvendësve të tyre.

9.3 Për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të komisionit, si dhe zëvendësit e tyre caktohen personat me specializim të kryer pas fakultetit dhe me së paku pesë (5) vite përvojë pune në lëmit e tyre.

9.4 MPMS-ja në komision mund të caktojë edhe personin me kualifikim superior në lëmin e shkencave sociale, por jo më shumë se një (1) anëtar.

9.5 Anëtari i komisionit të shkallës së parë nuk mund të jetë njëkohësisht edhe anëtar i komisionit të shkallës së dytë.

Neni 10 **Komisioni i shkallës së parë**

10.1 Për anëtar të Komisionit caktohen:

- a) nëpunës i shërbimeve sociale;
- b) mjek specialist i pediatriisë;
- c) mjek specialist i oftalmologjisë - ORL;
- d) mjek specialist fiziatër – ortoped;
- e) mjek specialist i neurologjisë ose neuropsikiatriisë;
- f) mjek specialist i psikiatriisë .

10.2 Çdo anëtar i Komisionit të shkallës së parë i caktohet zëvendës nga lëmi i njëjtë i specializimit.

10.3 Për kryetar të Komisionit të shkallës së parë emërohet mjeku specialist i pediatriisë.

Neni 11 **Komisioni i shkallës së dytë**

11.1 Për anëtar të Komisionit të shkallës së dytë caktohen:

- a) nëpunës i shërbimeve sociale,
- b) mjek specialist i pediatriisë,
- c) mjek specialist i oftalmologjisë -ORL
- d) mjek specialist fiziatër - ortoped,
- e) mjek specialist i neurologjisë ose psikiatriisë.

11.2 Çdo anëtar i Komisionit për ekspertizë në shkallë të dytë i caktohet zëvendësi nga lëmi i njëjtë i specializimit.

11.3 Për kryetarë të Komisionit të shkallës së dytë caktohet mjeku specialist i pediatriisë.

11.4 Kryetarit të Komisionit i caktohet zëvendësi, nga i njëjti specializim.

KREU IV

Procedura për ekspertizë

Neni 12

12.1 Qendra për Punë Sociale, në vijim QPS, e cila zhvillon procedurën për njohjen e ndihmës materiale, familjes me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme, nëse konsideron se duhet të bëhet ekspertiza, nxjerr konkluzë dhe ia dorëzon të gjithë dokumentacionin komisionit të shkallës së parë për ekspertizë.

12.2 Në bazë të konkluzës së QPS-së dhe shënimeve të prezantuara, kryetari i Komisionit të shkallës së parë për çdo ekspertizë fton anëtarët e komisionit të cilët e japin mendimin me shkrim për rastin konkret, pasi të kenë shqyrtuar dokumentacionin dhe ta kenë ekzaminuar personin.

12.3 Anëtarët e Komisionit mund të japin mendime të ndara për ekspertizën e bërë në rastin konkret, dhe pas analizës së të gjitha vlerësimeve të ekspertëve, përpilohet raporti i përbashkët me shkrim të cilin e nënshkruan kryetari i Komisionit si dhe të gjithë anëtarët e tjerë të cilët kanë marrë pjesë në ekspertizën e personit.

Neni 13

13.1 Komisioni i shkallës së parë është i obliguar që mendimin e vet lidhur me rastin ta dorëzojë më së voni në afatin prej njëzetënjë (21) ditëve nga dita e marrjes së përfundimit për kryerjen e ekspertizës.

13.2 Komisioni i dorëzon QPS-së raportin me shkrim në dy (2) kopje dhe të gjitha shënimet e tjera përcjellëse lidhur me rastin konkret.

13.3 Dokumentacioni lidhur me mendimin e dhënë në raport është fshehtësi profesionale.

13.4 Raporti i Komisionit duhet të përmbajë:

- a) shënimet personale të personit;
- b) diagnozën shëndetësore të personit;
- c) llojin, shkallën dhe peshën e dëmtimit fizik, mendor apo shqisor;
- d) ekzistimin e nevojës për ndihmë dhe kujdes të përhershëm;
- e) datën e raportit dhe nënshkrimin; dhe
- f) rekomandimin e mjekut për vlerësimin e serishëm të gjendjes shëndetësore.

Neni 14

Procedurat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Komisionit të shkallës së dytë

14.1 Pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të shkallës së parë të nxjerrë nga QPS-ja, vendim i cili është nxjerrë në bazë të raportit të Komisionit të shkallës së parë. QPS-ja të gjithë materialin ia dërgon Komisionit të shkallës së dytë për ekspertizë të re nëse kjo është e nevojshme për të vendosur në shkallën e dytë. Ankesa ushtrohet nëpërmjet organit i cili ka nxjerrë vendimin në shkallë të parë.

14.2 Komisioni i ekspertëve i shkallës së dytë ka të drejtë në bazë të dokumentacionit ekzistues dhe atij plotësues për rastin konkret sipas ankesës ta aprovoj, refuzoj ose ta kthejë lëndën në rishqyrtim tek Komisioni i shkallës së parë.

14.3 Raporti i Komisionit të shkallës së dytë jepet me shkrim në dy (2) kopje, i përmban të gjitha elementet si dhe raportin e Komisionit të shkallës së parë.

Neni 15

(1) Komisioni i cili kryen ekspertizën mban evidencën për punën e bërë administrative nga momenti i marrjes së konkluzës për kryerjen e ekspertizës, për dokumentet e marra, për seancat e mbajtura të Komisionit, për personat për të cilët është bërë ekspertiza.

Neni 16

16.1 Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për ekspertizë u takon e drejta në shpërblim për punën e tyre.

16.2 Lartësia e kompensimit, mënyra e pagesës caktohet me aktin e caktimit të ekspertëve ose me akt tjetër të veçantë.

16.3 Mandati i Komisioneve për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme zgjat dy (2) vjet.

KREU V

Procedurat Administrative të realizimit të të drejtave

Neni 17

Mjetet financiare për zbatimin e këtij Ligji sigurohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Neni 18

18.1 Përkrahjen materiale mund ta realizojë personi gjegjësisht familja, pa marrë parasysh gjendjen materiale të ti/saj apo të familjes së tij/saj, nëse ka fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme.

18.2 Kërkesa për përkrahje materiale i dërgohet QPS-së, në çdo kohë deri sa fëmija me aftësi të kufizuar të përhershme t'i mbushë 18 vjeç.

18.3 Kërkesa paraqitet duke plotësuar formularin të cilin e përgatitë Departamenti për Mirëqenie Sociale dhe të njëjtës i bashkëngjiten dokumentet që kërkohen nga MPMS – Departamenti për Mirëqenie Sociale.

Neni 19

Kërkesës për realizimin e përkrahjes materiale duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:

- a) fotokopje e letërnjoftimit të parashtruesit të kërkesës;
- b) lajmërimin e vendbanimit të fëmijës me aftësi të kufizuar të përhershme;
- c) certifikatën e lindjes, për fëmijën;
- d) aktvendimi për kujdestar, nëse kërkesën e parashtron kujdestari;
- e) dokumentacioni mjekësor me epikriz.

Neni 20

Realizimi i kësaj të drejte nënkupton shtesën e posaçme me të holla , të cilën Ministria ua jep familjes apo kujdestarit të fëmijës me aftësi të kufizuar, e të cilët për shkak të sëmundjes së rëndë fizike, mendore apo shqisore të lindur ose të paraqitur më vonë, të cilët për plotësimin e aktiviteteve të përditshme jetësore janë të kushtëzuar në ndihmën e personave të tjerë, për çka familja ka shpenzime të shtuara dhe të jashtëzakonshme.

Neni 21

21.1 Drejtori i QPS-së nxjerr vendim në bazë të:

- a) kërkesës me shkrim, drejtuar QPS-së;
- b) fotokopje të letërnjoftimit;
- c) certifikatës së lindjes;
- d) raportit të Komisionit mjekësor për shëndetin e fëmijës me aftësi të kufizuar të përhershme,
- e) shënimet për familjen apo personin i cili kujdeset për fëmijën me aftësi të kufizuara të përhershme.
- f) informatat e vendbanimit të fëmijës me aftësi të kufizuara ‘’ .

22.2 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me akt të veçantë mund të kërkojë edhe dokumente të tjera përveç atyre të parapara në nenin 19 dhe 21 të këtij Ligji.

Neni 22

Parashtrimi i kërkesës dhe vendosja

22.1 Prindi ose kujdestari, bën kërkesë me shkrim, në QPS për njohjen e të drejtës për përkrahjen materiale për kujdesin e fëmijës me aftësi të kufizuar të përhershme.

22.2 QPS-ja nxjerr aktvendimin me të cilin njihet e drejta për ndihmë materiale prindit ose kujdestarit me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme.

22.3 Aktvendimi përmban shënime për fëmijën i cili gëzon këtë të drejtë dhe shënimet për familjen, respektivisht personin i cili e realizon ndihmën materiale për kujdes, si dhe lartësinë dhe mënyrën e realizimit të përkrahjes (ndihmës) materiale.

22.4 Lartësia e shumës mujore për përkrahje materiale familjes së fëmijës me aftësi të kufizuar të përhershme përcaktohet me akt nënligjor të cilin e nxjerr MPMS-ja.

Neni 23

E drejta e Ankimit

23.1 Pala e pakënaqur me vendimin e QPS-së ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

23.2 Ankesa i drejtohet autoritetit përkatës, Departamentit të Mirëqenies Sociale, përmes QPS.

23.3 MPMS-ja lidhur me ankesën e paraqitur nga pala, mund të vërtetojë: vendimin e Shkallës së parë, ta ndryshojë atë ose ta kthejë lëndën në rishqyrtim.

23.4 MPMS-ja në afat prej 30 ditësh do të nxjerrë vendim të ri lidhur me ankesën kundër vendimit të organit të shkallës së parë.

23.5 Vendimi i MPMS-së i shkallës së II është akt përfundimtar në procedurë administrative.

23.6 Pala e pakënaqur me vendimin e shkallës së II të MPMS-së ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Kompetente.

Neni 24

Konfidencialitetin e shënimeve personale të parashtruesve të kërkesave

24.1 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, garanton fshehtësinë për informatat personale, të cilat i kanë mbledhur prej parashtruesve të kërkesave, përveç rasteve tjera të parapara me ligj.

24.2 Familja e cila realizon përkrahjen materiale për kujdes dhe ndihmë fëmijës me aftësi të kufizuar të përhershme është i obliguar të lajmërojë të gjitha ndryshimet që ndikojnë në realizimin e kësaj të drejte.

24.3 Monitorimin e realizimit të kësaj të drejte e bën DMS-ja përmes QPS-së.

KREU VI

Dispozitat kalimtare

Neni 25

25.1 Për zbatimin e Ligjit, MPMS-ja mund të nxjerrë akte tjera nënligjore në afatin prej gjashtë muajsh nga dita e miratimit të këtij ligji, të cilat nuk mund të jenë në kundërshtim me këtë Ligj ose ligjet tjera në fuqi.

25.2 Njohja e të drejtës për përkrahje materiale njihet nga data e aplikimit për këtë të drejtë.

Neni 26

26.1 Me hyrjen e këtij Ligji në fuqi shfuqizohet çdo dispozitë e ligjit të aplikueshëm në Kosovë e cila është në kundërshtim me këtë Ligj.

26.2 Në mungesë të dispozitave të këtij Ligji, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e Ligjit për Shëndetësinë, Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor, dhe ligjeve të tjera të aplikueshme në Kosovë.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Ligji Nr. 03/L-022

16 maj 2008

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI